




KOMUNA VUSHTRRI



KOMPANIA RAJONALE UJËSJEJ
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD
MITROVICA
TEL.FAXI 003813-781, 3

fax. 01-4250



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. - 40000 Mitrovicë

Bazuar në nenin 5, 14 dhe 17 shkronja "P" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 04 Qershor 2008), nenin 13 paragrafi 1.6 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenin 7 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit Nr. prot. 02Nr. 1467/23 datë 08.12.2023 dhe Nr. 01-1747 dt. 08.12.2023 për bashkëfinancim të projektit, palët:

- K.R.U Mitrovica përfaqësuar nga znj. **Emine Peci, u.d.** Kryeshef Ekzekutiv (këtu e tutje, KRUM), dhe
- Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga z. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës (këtu e tutje, Komuna) me datën 29.08.2024 lidhin këtë:

ANEKS-MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është ndryshim plotësimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit Nr. prot 02Nr. 1467/23 datë 08.12.2023 për bashkëfinancimi i projektit "Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pantinë dhe Lagjen Mazhiqi në Vushtrrisë".

Neni 2 Ndryshim plotësimi

Ndryshim plotësimi i marrëveshjes me numër dhe datë të shënuar në nenin paraprak bëhet si vijon:

2.1. Te emërtimi i projektit si dhe te nenet: 1, neni 2 paragrafi 2.1, neni 3, neni 5 paragrafi 5.2 i Marrëveshjes bazë, fshihet togfjalëshi "fshatin Pantinë dhe", me arsyetimin se punët e zgjerimit/përmirësimit të infrastrukturës në fsh. Pantinë i kanë ekzekutuar banorët e këtij fshati me financat e tyre.



2.2 Te neni 2 i marrëveshjes bazë, zbritet vlera e përgjithshme e projektit nga 42,000.00 € (katërdhjetë e dymijë euro) në 24,568.00 € (njëzetë e katërmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro) ndërsa përqindja e bashkë financimit nga Komuna e Vushtrrisë dhe KRU “Ujësjetësi Mitrovicë” mbetet e njëjtë si në marrëveshjen bazë.



Nr. 3
Numri i ekzemplarëve

Aneks-Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në origjinal, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për KRUM. Marrëveshja përmban katër nene në dy faqe A/4.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Aneks-Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Komuna e Vushtrrisë,

Z. Ferit Idrizi,
Kryetar


KRU Mitrovica,

Znj. Emine Peci,
u.d. Kryeshef Ekzekutiv